

**MBI FIGURËN E SKËNDERBEUT NË VEPRËN E HUMANISTIT
GJERMAN JOHANES KUSPINIANUS***

**IOANNES CUSPINIANUS: “DE TURCORUM ORIGINE, RELIGIONE,
AC IMMANISSIMA EORUM IN CRISTIANOS TYRANIDE, DEQUE VIIS
PER QUAS CHRISTIANI PRINCIPES TURCOS PROFLIGARE &
INUADER FACILE POSENT. LIBER CAMPRIMUM NATUS ET AD
VTILITATEM REI PUBLICÆ CHRISTIANÆ ÆEDITUS. IOANNE
CUSPINIANO AUTORE”**

“Ioan. Steelsium”, **Antverpiæ, 1541**

**Dy fjalë rreth figurës së Johanes
Kuspinianit (Johannes
Cuspinianus)**

Një ndër personalitetet e shumta të humanizmit gjerman, që kanë shkruar për Skënderbeun ose që e përmendin atë nëpër veprat e tyre është edhe Johanes Kuspiniani (ose Johan Shpishajmer) (*Johannes Cuspinian alias Johann Spießheimer*). Kush ishte Johanes Kuspinian?^{**} Kuspiniani u lind në vitin 1473 në Shvainfurt të Gjermanisë, porse data e saktë e lindjes së tij nuk dihet.¹ Ai ishte humanist, mjek, diplomat, historian dhe poet. Studioi në Laipçig dhe Vyrzburg dhe në vitin 1492 erdhi



*Johannes Cuspinian.
Pikturuar nga L. Cranach
d. Ä., 1502.*

* Ky recension i shkurtër me disa ndryshime është pjesë e disertacionit tim me titull: “Skënderbeu në letërsinë shqiptare dhe gjermane që prej shekullit të 15-të”. Titulli i origjinalit gjermanisht: Edmond Malaj: “Skanderbeg in der deutschen und albanischen Literatur set dem 15. Jahrhundert”, Phil. Diss. an der Karl- Franzens-Universität Graz (Austria) 2007. Përkthimet nga latinishtja janë të miat.

** Mbi këtë figurë të njohur të humanizmit gjerman ia vlen të jepem disa të dhëna biografike.

¹ *Krh.* Hans Ankwicz-Kleehoven, *Der Wiener Humanist Johannes Cuspinian, Gelehrter und Diplomat zur Zeit Kaiser Maximilians I.* Graz / Köln: “Hermann Böhlau Nachf”, 1959, f. 5.

në Vjenë, ku gjatë ceremonisë mortore të Frederikut të III-të u kurorëzua si “poeta laureatus” nga Maksimiliani i I-rë.² Si student dhe më vonë si profesor universiteti ai pati kontakte me figura të ndryshme të humanizmit dhe u influencua nga kjo lëvizje që ishte përhapur nëpër universitetet evropiane të asaj kohe. Më 13 prill 1499 u promovua “Doktor i Mjekësisë” dhe u emërua profesor në Universitetin e Vjenës dhe më pas rektor i universitetit, pasi fakulteti i mjekësisë e kishte propozuar njëzëri për këtë post.³ Pas vdekjes së Konrad Celtis* (më 4 shkurt 1508), Kuspianiani mori përsipër “Katedrën e Retorikës dhe të Poetikës” dhe për këtë kohë ai mund të cilësohet si humanisti më i shquar i Vjenës.⁴ Që prej vitit 1510 u dërgua vazhdimisht në Poloni dhe Hungari me shërbime diplomatike (si orator) nga oborri perandorak⁵ dhe nëpërmjet kësaj veprimtarie diplomatike u bë i mundur edhe “Kongresi i Vjenës” i vitit 1515, nën perandorin Maksimilian I., mbretin Sigismund të Hungarisë dhe Vladislavit të Polonisë, ky kongres përfundoi më 28 korrik 1515, dhe më pas Kuspianiani qe edhe prefekt i Vjenës.⁶ Merita të mëdha ai mori edhe si zbulues dhe botues veprash burimore historike klasike dhe mesjetare. Kuspianiani vdiq më 19. 4. 1529 në Vjenë, nga një sëmundjeje akute, në moshën 56 vjeçare. Varri i tij gjendet brenda kishës katedrale të Shën Stefanit (Stephansdom) në Vjenë.⁷

Mbi figurën e Skënderbeut tek vepra e Johanes Kuspianit

Kuspianiani përveç të tjerash shkroi dhe një vepër mbi turqit, me titull “*Mbi Origjinën dhe religjionin e turqve dhe veçanërisht mbi tiraninë e tyre ndaj të krishterëve, dhe mbi mënyrat, me anë të së cilave princërit e krishterë mund ti sulmojnë dhe mund ti shpartallojnë turqit me lehtësi.*” (Titulli i

² *Krh. Po aty*, f. 8-11.

³ *Krh. Po aty*, f. 17-21.

* Po ashtu si Johanes Kuspianus, edhe Konrad Celtis është një nga figurat më të spikatura të humanizmit gjerman në shekullin e 15-të. Ai u kurorëzua si “poeta laureatus” nga Frederiku i III-të.

⁴ *Krh. H. Ankwic-Kleehoven, vep. e për., f. 43-44.*

⁵ *Krh. Po aty*, f. 47-77.

⁶ *Krh. Po aty*, f. 86.

⁷ Data e vdekjes gjendet në Katedralen e Vjenës (Stephansdom) në pllakën e varrit të tij aty, dhe në aktet e Universitetit të Mjekësisë në Vjenë me këtë mbishkrim: “Doctor Joannes Cuspianus, poeta, superintendens universitatis, prefectus urbis Viennensis, moritur anno 1529 die 19. Aprilis”. (Doktor Johannes Cuspianus, poet, rektor i universitetit, prefekt i qytetit të Vjenës, i vdekur në vitin 1529, ditën e 19 Prillit). *Po aty*, f. 257.

originalit: De Turcorum origine, religione, ac immanissima eorum in Christianos Tyranide, deque viis per quas christiani Principes Turcos profligare & inuader facile possent ...). Kjo vepër është shumë e pasur me të dhëna mbi turqit dhe u hartua në dobi princërve të krishterë në luftë kundër osmanëve. I përket një kohe kur turqit ishin kthyer me të vërtetë në një kërcënim edhe për vendet e krishtera të Evropës Perëndimore. Kuspianiani shkruan mbi origjinën e turqve dhe për këtë përdor shumë burime të kohës. Ai fillon me kronologjitë e sulltanëve të ndryshëm duke treguar mbi jetën, bëmat dhe pushtimet e tyre. Pra kjo vepër nuk i kushtohet në mënyrë të veçantë Skënderbeut, megjithëse emri i tij përmendet aty disa herë. Autori fillon me të dhënat mbi Skënderbeun në kapitullin mbi Muratin e II-të dhe Mehmetin e II-të. Informacionet që sjell Kuspianiani mbi Skënderbeun në këtë vepër i shmangen pak veprës së Barletit dhe duhet të theksohet këtu që kjo vepër (*Historia e Skënderbeut nga Barleti*) ishte përkthyer në atë kohë në shumë gjuhë dhe përhapur kudo në Evropë dhe po të shohim sot letërsinë gjermane mbi Skënderbeun, qoftë atë historike, qoftë atë letrare të asaj kohe dhe të shekujve me pas, vëmë re që pothuajse të gjitha veprat i referohen kryesisht veprës së Barletit.⁸

Në lidhje me historinë e Skënderbeut, Kuspianiani fillon me humbjen e Gjon Kastriotit, babait të Skënderbeut. Dhe si shenjë të njohjes së sulltanit si sundimtar, Gjoni është i detyruar ti japë peng Muratit të tre djemtë e tij Konstantinin, Reposhin dhe Gjergjin, të cilin turqit e quajtën Iskanderbeg “gjë që në gjuhën e tyre të vendit do të thotë zoti Aleksandër ose i Madhi Aleksandër”.⁹ Stanisha, më i madhi vëlla i Skënderbeut, - vazhdon më tej Kuspianiani – nuk u dha peng nga i ati tek sulltani në të njëjtën kohë me vëllezërit e tij,¹⁰ por disa kohë më pas, së bashku me djem të tjerë, pengje, në kohën kur në Epir erdhi Isa Begu.¹¹ Në lidhje me Skënderbeun Kuspianiani e lë lexuesin të nënkuptojë qysh në fillim, se bëhet fjalë për një hero të madh, kur ai

⁸ Në gjuhën gjermane “*Historia e Skënderbeut*” e Marin Barletit u përkthye nga Johannes Pinicinaus dhe u shtyp disa herë: 1533 në Augusta (Trier), 1561, 1577, 1578, 1597 në Frankfurt mbi Majn, 1606 dhe 1606 në Magdeburg. *Krh.* Stefan Prifti, “Hyrje”, në: Marin Barleti, *Historia e Skënderbeut*. (Përkthimi nga origjinali latinisht dhe hyrja nga Stefan J. Prifti), Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë: “Mihal Duri”, 1967, f. 10.

⁹ *Krh.* “Ioannes Castriotus, cui omne Epiroticum nomen parebat. Vt vim bellicam omnem amoueret, tres filios, cum Croia Illyriorum aoppido haud ignobili obsides dedit Amurato, Condantinum, Reposium, & Georgium quem Turci Scanderbechum dixere. Quod lingua patria significat Alexandrum Dominum siue Magnum”. I. Cuspianianus, *vep. e për.*, f. 18-19.

¹⁰ Megjithatë Barleti shkruan që tek sulltani u çuan peng të katër vëllezërit së bashku. *Krh.* M. Barleti, *vep. e për.*, f. 51.

¹¹ *Krh. Po aty*, f. 19.

i cilëson veprat e tij si „vepra heroike të arritura me një dinjitet dhe me një forcë fizike të pakrahasueshme“¹².

Më pas ai nuk merret për momentin më gjatë me jetën e Skënderbeut. Në veprën e tij nuk ka informacione mbi kohën që kaloi Skënderbeu tek turqit. Për atë bëhet fjalë përsëri, kur Kuspiani trajton luftën e Muratit të II-të kundër Janosh Huniadit, në të cilën duhet të merrte pjesë edhe Skënderbeu. Skënderbeu – vazhdon më tej ai – e braktis ushtrinë e Muratit dhe shkon në Epir, ku kthehet në fenë e tij të mëparshme të krishterë dhe çliron shumë krahina nga pushtuesi turk.¹³ Skënderbeu „çliron (në tekst: pushton) papritmas qytetet e fortifikuara Krujë, Sfetigrad, Stelushi, Modricë dhe Ternacia (?)“, të cilat ndodheshin në krahinat, që i kishte pasur dikur nën zotërim babai i tij.¹⁴ Aty thuhet që Murati i II-të nis Hamza Begun (Amessam Begh), të birin e të vëllait (pra, nipin e Skënderbeut) dhe Vranën, nën funksionin e kapedanit të një ushtrie kundër Skënderbeut.¹⁵

Të dhënat e Kuspianit këtu nuk janë të sakta, pasi Hamza Kastrioti kaloi më vonë në anën e turqve dhe sepse Vrana (Vrana Konti), njëri nga oficerët më të rëndësishëm të Skënderbeut nuk ishte kurrë në shërbim të sulltanit turk, dhe si rrjedhim nuk u dërgua kurrë nga Murati i II-të kundër Skënderbeut. Më tej ai shkruan që kështjella e Krujës u mbajt e rrethuar katër muaj rresht, por papritmas Murati i II-të vdes dhe i biri i tij Mehmeti e sheh veten të detyruar të ndërpresë rrethimin dhe thërret dy gjeneralët e lartpërmendur (Hamzanë dhe Vranën) që të kthehet me të gjithë ushtrinë.¹⁶ Këtu ia vlen të përmendet, që Murati i II-të nuk vdiq nën muret e Krujës, gjatë rrethimit, por në fund të janarit të vitit 1451 në kryeqytetin e tij Edirne.¹⁷ Për çudi në kapitullin, që Kuspiani i kushton Mehmetit të II-të, nuk bëhet më fjalë

¹² “Fuit enim puer hic nouem annorum cum daretur obsef. Sedindole & virtute creuit heroica, et robore corporis incomparabili”. I. Cuspianus, *vep. e për.*, f. 19.

¹³ “Etenim Schenderbegus postquam in suam sectam ascitus est, plures ei prouincias adquisiuit”. *Po aty*, f. 29.

¹⁴ *Krh.* “Ac de improuiso Croiam, Sfetigradum, Stelusium, Modriciam & Ternaciam oppida in ea regione occupat”. *Po aty*.

¹⁵ *Krh.* “Amurathus contra eum Amesambech fratris eius filium, deinde Vranaum Duces cum copiis mittit”. *Po aty*.

¹⁶ *Krh.* “Croiam quatour menses obsidebat, cum moritur. Ac filius missis totide Ducibus quos Bassos vocant, frustra vires instaurat, cum ille semper parva manu ingentes hortium cateruas funderet ac fugaret”. *Po aty*.

¹⁷ *Krh.*, Fan S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu 1405-1468*. (Titulli i origjinalit: *Georg Kastriot Skanderbeg (1405-1468)* by Bishop Fan Stilian Noli Ph. D.). Tiranë: “Naim Frashëri”, 1967, f. 102; *Krh.* Kristo Frashëri, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Jeta dhe Vepra (1405-1468)*. Tiranë: “Toena”, 2002, f. 175.

për Skënderbeun. Në këtë kapitull ai shkruan edhe për rrethimin dhe pushtimin e Krujës dhe të Shkodrës.

Nga gjithë ajo çfarë shkruan Kuspianiani mbi Skënderbeun, del që ai, me sa duket, nuk e njihje veprën e Barletit, sepse edhe këtë herë të dhënat e tij përsëri nuk përputhen me ato të Barletit. Ai mund të ketë përdorur edhe ndonjë tekst që sidoqoftë i referohet Barletit, por me ndonjë gabim. Si konkluzion duhet të thuhet që vepra e Kuspianianit në lidhje me të dhënat që sjellë për jetën dhe për veprën e Skënderbeut nuk paraqet ndonjë vlerë të madhe, pasi këto të dhëna nuk përkojnë plotësisht me faktet historike. Por sidoqoftë kjo vepër ka vlerën e vet, pasi ajo e pasuron bibliografinë e letërsisë skënderbegiane dhe është një „unazë“ më tepër zinxhirin e gjatë të kësaj letërsie.

Edmond MALAJ

Literatura e përdorur

- ANKWICZ-KLEEHOVEN, Hans - *Der Wiener Humanist Johannes Cuspinian. Gelehrter und Diplomat zur Zeit Kaiser Maximilians I*, Graz/ Köln: Hermann Böhlau Nachf. 1959.
- BARLETI, Marin - *Historia e Skënderbeut*. (Përkthimi nga origjinali latinisht dhe hyrja nga Stefan J. Prifti), Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë: “Mihal Duri”, 1967.
- CUSPINIANUS Ioannes - *De Turcorum origine, religione, ac immanissima eorum in Cristianos Tyranide, deque viis per quas christiani Principes Turcos profligare & inuader facile posent. Liber Camprimus natus et ad vtilitatem Rei Publicæ Christianæ æditus. Ioanne Cuspiniano autore. Res nova et Chrsitianis auribus inaudita, ANTVERPIÆ, Apud Ioan. Steelsium in Scuto Burgundiæ. Anno 1541.*
- FRASHËRI, Kristo - *Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Jeta dhe Vepra (1405-1468)*, Tiranë: “Toena”, 2002.
- NOLI, Fan S. - *Gjergj Kastrioti Skënderbeu 1405-1468*. (Titulli i origjinalit: Georg Kastriot Skanderbeg (1405-1468) by Bishop Fan Stilian Noli Ph. D.) Tiranë: “Naim Frashëri”, 1967.
- Portreti i Johanës Kuspianianit, pikturë nga L. Cranach d. Ä., 1502.** marrë nga ANKWICZ-KLEEHOVEN, Hans: *Der Wiener Humanist Johannes Cuspinian. Gelehrter und Diplomat zur Zeit Kaiser Maximilians I*. Graz/ Köln: Hermann Böhlau Nachf. 1959, pas faqes 8. (pa numër faqeje)